
Gjendja social-ekonomike dhe profili i turizmit në Parkun Kombëtar Prespa

GRAZHDANI, D.

Universiteti Bujqësor i Tiranës, Fakulteti i Ekonomisë dhe Agrobiznesit

PËRMBLEDHJE

Qëllimi i këtij studimi është të pasqyrojë gjendjen aktuale të turizmit në Parkun Kombëtar Prespa dhe të vlerësojë tendencat bazë të zhvillimit ekonomik sipas sektorëve primarë, përdorimin e burimeve natyrore dhe njerëzore, të vlerësojë indikatorët socialë dhe tendencat e tyre, infrastrukturën teknike dhe atë kulturore që ndikojnë negativisht ose pozitivisht mbi turizmin, si edhe të vlerësojë ndikimin e elementëve/faktorëve që kanë lidhje me turizmin në cilësinë e mjedisit. Disa përfundime që dalin nga ky studim janë si më poshtë. Turizmi nuk ka një ndikim të madh, veçanërisht mbi burimet e PKP/biodiversitetin, me përjashtim të cilësisë së mjedisit. Zhvillimi i sektorit të turizmit është i kufizuar për shkak të mungesës së infrastrukturës, menaxhimit të mbeturinave të ngurta dhe i ujrave të zeza, furnizimi me ujë të pijshëm dhe energji elektrike. Numri vjetor i vizitorëve në rajonin e Prespës është relativisht i ulët dhe ritmi i zënies së hoteleve dhe sidomos i shtëpive private është po ashtu i ulët. E ardhura e siguruar nga restorantet dhe hotelet është më e madhe se e ardhura mesatare e familjes në zonë.

Fjalët kyçe: turizëm, social ekonomik, Parku Kombëtar Prespa, indikator, infrastrukturë, vizitorë.

SUMMARY

The study analyses and evaluates the social economic state and tourism profile in National Park Prespa (NPP). Prespa area is an area internationality known for its ecological importance. Most of the households in Prespa Commune are engaged in agriculture (farming, and livestock production). Farming is labour intensive. Livestock husbandry is integral to the farming system. On average, households cultivate all of their land growing wheat, maize, potato, alfalfa, and vegetables. Almost all of households hold one or two cows mainly for milk, ten to fifteen chickens and few sheep and goats. Fishery is another important income source in Prespa. Most of farmers, also, have to rent tractors for cultivation, combines for harvesting, as well as family labour for fertilizer and seed applications. The Prespa region has, besides its natural beauty and values regarding flora and fauna, many cultural and historical values that may be considered as one of the most important factors in the regions for attracting tourists. The human popularization of the ecosystem of "National Park Prespa" has been characterized by its own specific dynamics. The population distribution is not uniform among the villages. About 65 percent of the population is categorized as a labour force. The household in Prespa area consists of about 3.7 persons, showing a declining trend in years. The population is still dominated by the young population. Fortunately there is not an employment shortage at present. According to the data provided by us, about 28% of labor forces are unemployed. Tourism in the Prespa area is small-scale rural and family tourism, based on few small hotels, private accommodation and restaurants. Most tourists are domestic tourists. Capacities for overnight stay in hotels 34 beds, for private accommodation 500 beds and there are 11 restaurants with 345 seats. The occupancy rate for the few hotels ranges from 9 – 19 % and for private accommodation between 0.02 – 3 %. Restaurants are reported to have 200 – 1 000 visitors per day at the weekends during the main summer seasons (July and August), resulting approximately 2 400 – 12 000 visitors a year. It is estimated that the tourism sector in NPP employs approximately 40 permanent staff and 50 seasonal staff.

Key words: tourism, social economic, National Park Prespa, indicator, infrastructure, tourist.

HYRJE

Aktiviteti ekonomik në Parkun Kombëtar Prespa përmbledh një shumëllojshmëri aktivitetesh të përdorimit të burimeve natyrore (si bujqësia, mbarështrimi i blegtorisë, pylltaria dhe peshkimi), ku shkalla e intensitetit, metodat dhe proceset e zbatuara në to përbëjnë, në shumë raste, një kërcënim potencial mbi mjedisin natyror lokal. Në këtë kontekst, zhvillimi dhe menaxhimi i përshtatshëm i bazuar dhe kompatibël me vlerat ekologjike të Parkut Prespa mund të sigurojë një numër “mallrash & shërbimesh” dhe përdorimin më miqësor të burimeve natyrore dhe të ketë si rezultat krijimin e një tregu për produkte të prodhuara me standarte.

Popullsia dhe komuniteti lokal i kanë vënë një theks të madh zhvillimit të turizmit në zonë. Ndërkaq, rritja aktuale e turizmit në zonë është e kufizuar, bile edhe në një të ardhme të afërt, dhe do të varet nga një numër faktorësh, ndër më të rëndësishmit mund të përmëndim mungesën e infrastrukturës së domozdoshme për zhvillimin normal të këtij aktiviteti, menaxhimin e mbeturinave të ngurta dhe i ujrave të zeza, furnizim me ujë të pijshëm dhe energji elektrike. Mungesa aktuale e investimeve kapitale mund të vonojë më tej rritjen e mëvonshme të sektorit turistik në zonë.

Në këtë kuadër u ndërmor nga ne ky studimi, i cili ka për objektiv të realizojë një analizë të gjendjes social ekonomike si edhe të japë profilin e turizmit në Parkun Kombëtar Prespa.

MATERIALI DHE METODA

Për të grumbulluar të dhënat e nevojshme për realizimin e këtij studimit, u përdor nga ne disa metoda. Së pari, u përdor metoda e intervistimit. Për këtë qëllim, u realizua në mënyrë të rastit një zgjedhje prej 200 kryefamiljarë (në mungesë të tyre, të një pjestari tjetër të familjes), duke përdorur tabelën e numrave të rastit. Intervistat u realizuan gjatë periudhës Shtator-Tetor 2006. Me anën e kësaj metode u morrën të dhëna që kishin të bënin me katër vitet e fundit të prodhimit bujqësor, blegtoral, peshkimit dhe të çmimeve të shitjes së tyre, menaxhimit të pyjeve, mbi karakteristikat e punësimit dhe nivelit të papunësisë, mbi cilësinë e mjedisit dhe të nivelit të përdorimit të pesticideve dhe elementëve ushqyes. Gjithashtu, u morrën të dhëna edhe mbi disa karakteristika të tjera

social-ekonomike si p.sh. mbi strukturën dhe karakteristikat social-ekonomike të familjes, mbi nivelin e kooperimit, nivelit të përpunimit të produkteve bujqësore etj. Së dyti, u përdor metoda e grumbullimit të të dhënave nga pushteti lokal. Së treti, u shfrytëzuan nga materiale të botuara ose të pabotuara nga agjensi dhe shoqata lokale (Agjensia e Mjedisit Korçë dhe Devoll, Shoqata e Pyjeve Komunalë Liqenas etj.) ose publike kombëtare (INSTAT) dhe ndërkombëtare (GFA, KfW etj.) dhe së fundi, u shfrytëzuan edhe punime të tjera të realizuara më parë në Parkun Kombëtar Prespa (Strategic Action Plan for the Sustainable Development of the Prespa Park, 2005; UNDP/GEF reports, 2004; KfW, Report, 2005; Introduction of a Prespa Park Trademark, 2006).

REZULTATE DHE DISKUTIME

1. Gjendja social-ekonomike në Parkun Kombëtar Prespa

Në këtë seksion të punimit jepen rezultatet e marra nga informacioni i grumbulluar, me qëllim për të përcaktuar varësinë ndërmjet liqenit, turizmit dhe ekonomisë lokale.

Problemet kryesore me të cilët përballet bujqësia janë: Së pari, ekzistenca e një ferme bujqësore me një përmasë minimale, e frangmentarizuar (e ndarë në disa ngastra), e mbyllur në vetvete dhe e orientuar drejt plotësimit të nevojave të familjes dhe së dyti, ekzistenca e një familjeje relativisht të madhe, e cila duhet të operojë në një mikro fermë. Nën këto kushte, fermerët kanë përshtatur një sistem të ndërlikuar prodhimi që përfshinë një numër të madh bimësh dhe kafshësh. Prodhimi i përzjerë (p.sh bujqësor dhe blegtoral) përbën sistemin predominues të prodhimit bujqësor, i cili mbulon nevojat kryesore të familjeve. Drithrat e bukës (gruri, misri, elbi dhe tërshëra) janë bimët bujqësore kryesore që zenë pothuajse 70 % të tokës së plotë të kultivuar, ndërkaq mbarrështrimi i deleve, dhive dhe lopëve (duke përfshirë racat lokale) luan gjithashtu, rol në jetesën e popullsisë lokale. Ndërkaq, ekzistojnë potenciale të mira për praktikimin e bujqësisë organike, sepse nuk përdoren ose përdoren në sasi shumë të vogla pesticidet dhe plehrat kimike, gjë e cila përbën një potencial të madh për zhvillimin e turizmit.

Nga përpunimi i të dhënave të grumbulluara nga ne, në lidhje me zhvillimin e

numrit të bagëtive blegtorale, dalin përfundimet e mëposhtme: numri total i dhive dhe deleve do të vazhdojë edhe në të ardhmen që të zvogëlohet ngadalë; numri i lopëve do të rritet ose do të mbetet i pandryshuar; disa fermerë do të specializohen në mbarështrimin e blegtorisë dhe do të risin përmasën e tufës blegtorale, por më tepër në lopë e dele, sesa në dhi. Secila familje ka mesatarisht 4 dele, 5 dhi dhe një lopë. Sasia e plotë e mishit të prodhuar nga një familje është rreth 210 kg (Grazhdani, 2007). Nga kjo, mesatarisht rreth 160 kg (80 %) konsumohet në familje, d.m.th. kemi një konsum mishi prej 40 kg gjatë një vit për çdo person (duke pranuar se familja përbëhet mesatarisht nga katër persona). Po ashtu, rreth 60 – 70 % e familjeve therrin një derr në vit, nëse ato e shesin viçin.

Shfrytëzimi i pyjeve, i kryer nga popullsia lokale (kullotja, prerja e gjetheve për ushqim blegtorie, gjenerimi i druve të zjarrit) kryesisht për konsum vetjak, por edhe për gjenerim të ardhurash (shitja e druve të zjarrit komuniteteve jashtë PKP) ka çuar në një degradim të madh të shumicës së sipërfaqeve pyjore. Më shumë se 50% e pyjeve nuk mund të quhen akoma pyje. Kullotat dhe livadhet e njoma, si edhe brigjet e liqeneve të Prespës janë, gjithashtu habitate të rëndësishme që janë nën trysni nëpërmjet përdorimit të paqendrueshëm të burimeve. Nga vlerësimi i kryer nga ne doli se prodhimi i plotë i druve të zjarrit në PKP është rreth 20 000 m³ stere.

Gjuetia e peshkut është burimi kryesor i të ardhurave për rreth 50 familjeve në Prespën e Madhe. Nga informacioni i grumbulluar nga ne del se sasia e llojit të peshkut, i vlerësueshëm nga pikëpamja ekonomike, siç është krap (*Cyprinus carpio*), është zvogëluar, ndërsa sasia e llojeve të tjerë peshku, që kërkohen më pak, është rritur. Kapja ditore mesatare, ndërmjet muajit Prill dhe Tetor, nga një peshkatar është 25 kg, për peshqit e vegjël (dhe një sasi e vogël krap). Ndërmjet muajve Nëntor dhe Mars, kapja mesatare ditore është 1.5 kg krap (dhe sasi të vogla nga peshqit e vegjël).

2.Indikatorët demografikë dhe tendencat e tyre

Në këtë seksion të punimit jepen rezultatet nga informacioni i grumbulluar që ka të bëjë me dinamikën e popullsisë në zonë i strukturës gjinore dhe asaj moshore të popullsisë, forcave të punës dhe i nivelit të punësimit. Popullsia e ekosistemit të Parkut

Kombëtar Prespa është karakterizuar nga dinamika e saj specifike në përputhje me trysninë humane të ushtruar mbi këtë ekosistem. Në Parkun Kombëtar banojnë 1 448 familje me një numër mesatar personash prej 3.7. Pothuajse të gjithë kryefamiljarët janë burra. Ata janë kryesisht me moshë të vjetër, sepse shumica e tyre (76.6 %) janë 40 vjet e sipër.

Në strukturën gjinore femrat përbëjnë 48.5 % të popullsisë totale të zonës, ndërsa meshkujt 51.5 %. Edhe struktura gjinore ka patur dinamikën e saj në vite. Popullsia dominohet nga moshë e re. Kështu, rreth 24.2 % të popullsisë së plotë ka moshë (0 – 15 vjet), ose grupi i quajtur i paaftë për punë, 66 % e saj është ndërmjet 15 – 65 vjet (grup moshë e aftë për punë) dhe vetëm 9.8 % e popullsisë klasifikohet mbi 65 vjet (e ashtuquajtura moshë e tretë). Krahasuar me të dhënat e vitit 1989, në mënyrë të dukshme rezultojnë një tendencë në zvogëlim të përqindjes së grup moshës më të re (nga 28.7 % në 24.2 %) dhe rritje të moshës së tretë (nga 7.3 % në 9.8 %). Kjo “plakje” e popullsisë vjen jo aq shumë nga rritja e numrit të personave që futen në grup moshën e tretë sesa nga një zvogëlim të peshës specifike të moshës së re në popullsinë e plotë. Shkaku është i dyfishtë: zvogëlimi i ritmit natyral të riprodhimit; numri më i madh i njerëzve më të rinj që hyjnë në moshën që është e aftë për punë, por pa u zëvendësuar ndërkaj nga riprodhimi natyral. Rreth 70 % e pjesëtarëve të grup moshës së aftë për punë janë mbi 30 vjet.

Bazuar në të dhënat e grumbulluara si edhe në intervistat e realizuara, analiza e punësimit në fermë tregon se ka pak mundësi për punësim me kohë të plotë, meqë përmasa e fermave dhe numri i bagëtive që mbarështrohen në to është i vogël. Kjo analizë tregon se punësimi me kohë të pjesshme (70 %) e tejkalon shumë punësimin me kohë të plotë (30 %), një fakt që tregon ekzistencën e një ekonomie me shumë aktivitete (ose ekonomie me jetësë në vështirësi) në zonën e Prespës. Forca e aftë për punë në zonë rezultojnë e punësuar në mënyrë jo të frytshme. Rezultojnë se kjo kategori mbahet pjesërisht e zënë me punë (72 %). Për rrjedhojë, 28 % është pjesërisht e papunësuar. Në veçanti, njerëzit të grup moshës 16 – 30 vjet janë pak të lidhur me fermat bujqësore. Sfidat kryesore me të cilat duhet të përballet komuniteti i këtij ekosistemi është zhvillimi i turizmit, i cili krijon mundësi

punësimi në të ardhmen në këtë sektor e kësaj force të lirë pune.

3.Profili i turizmit në PKP

Në këtë seksion të punimit do të diskutohet mbi infrastrukturën fizike të turizmit si dhe ajo historike në PKP, me qëllim për të profilizuar disa indikatorë që kanë lidhje me turizmin, me cilësinë e mjedisit, si edhe rolin e turizmit në të ardhurën e familjes. Turizmi në zonën e Prespës është një turizëm rural dhe familjar i bazuar në disa hotele dhe restorante të vegjël. Shumica e turistëve janë turist të vendit dhe vijnë nga rajoni i Korçës dhe i Devollit, kryesisht si udhëtime ditore në fundjavë. Vetëm pak turistë vijnë nga Tirana. Karakteristikat e zonës së Prespës që pëlqehen nga vizitorët vëndas janë, veçanërisht liqeni, ajri i pastër, mjedisi i qetë dhe paqësor dhe vendet historike. Rajoni është i njohur për ushqimin tradicional dhe me cilësi të lartë dhe për popull mikpritës.

Kapaciteti për akomodim i hoteleve për një natë në zonën e Prespës është 34 shtretër, ndërsa ai privat shtëpiak është 500 shtretër. Në përgjithësi, numri vjetor i vizitorëve është relativisht i vogël dhe ritmi i zënies së tyre i ulët. Ritmi i zënies për hotelet është ndërmjet 9 – 20 % dhe për shtëpitë private ndërmjet 0.02 deri 3 %. Në zonë ka 11 restorante me 345 vende. Restorantet mund të kenë 200 – 1 000 vizitorë për një ditë dhe në fundjavë, gjatë sezonit të verës (Korrik dhe Gusht) dhe në rreth 2 400 – 12 000 vizitorë për vit.

Rajoni i Prespës, përveç bukurisë së tij natyrale si edhe vlerave në lidhje me florën dhe faunën, ka shumë vlera kulturore dhe historike dhe mund të konsiderohet si një nga faktorët më të rëndësishëm për tërheqjen e turistëve. Ka shumë vendbanime prehistorike (shpella e Trenit në Prespën e Vogël, fortifikimi në shpellën e Trenit, fortesa e Trajanit, Murri i Zvezdës etj.), kisha (Kisha e Shën Marisë në Ishullin Mali Grad, Prespa e Madhe) dhe kapele hermite (Kapela Hermite e Shën Mërisë afër fshatit Kallamas, Kapelja Hermite të Michael dhe Gabrielle afër kufirit me Greqinë, Kapela Hermite Evangjeliste në Cërnapesh – Gollomboç). Kapelet hermite, përveç vlerës ndërtimore, përmbajnë shumë metra katrore piktura murale të kohës së Bizantit dhe post Bizantit.

Niveli aktual i turizmit nuk ka një ndikim të madh, veçanërisht në burimet e PKP/biodiversitetin (kështu mendojmë mbi 4/5 e të intervistuarve), me përjashtim të një

menaxhimi të papërshtatshëm të mbeturinave të ngurta dhe shkarkimeve të pakontrolluara të ujrave të zeza të prodhuara prej infrastruktures së përdorur prej tij. Burim tjetër për ndotjen e ujit të liqenit janë ujrat e zeza të prodhuara nga shtëpitë private si edhe nga mbeturinat blegtorale që vijnë nga mbarështrimi i blegtorisë pranë këtyre shtëpive. Me përjashtim të disa përpjekjeve të përkohëshme për të mbledhur mbeturinat e ngurta, nuk ka fasilite mbledhëse/heqëse në fshatrat e zonës. Ujrat e zeza mblidhen në depozita (gropa) individuale septike, gjysma e të cilëve lejojnë infiltrimin. Ujrat e zeza pastaj infiltrojnë në ujin tokësor dhe në liqen. Disa prej këtyre gropave septike zbrazen periodikisht në fushë. Mungesa e një infrastrukture drenimi për ujrat e zeza në të gjithë fshatrat nuk lejon që as edhe të mendohet për kushte të përshtatshme të turizmit familjar.

Nuk ka të dhëna statistikore të sakta rreth këtyre indikatorëve. Sipas disa vëzhgimeve të kryera në PKP ka rreth 4.2 t shkarkime humane gjatë 24 orëve. 1/3 e tyre është e pamundur që të zhduket siç janë p.sh., plastika, xhami, inertet etj. Gjithashtu, edhe nga mbarështrimi i blegtorisë prodhohen 5 t mbetje gjatë 24 orëve. Mbeturinat e lëngshme, të cilat rrjedhin lirshëm në sipërfaqe ose në liqen, janë 3 l/s për secilen vendbanim. Me zhvillimin e mundshëm të turizmit këta indikatorë do të kenë vlerë më të madhe. Në këtë drejtim kërkohet organizimi i trajtimit komunal i mbeturinave me anën e impianteve përkatëse. Prioritet mbetet, gjithashtu, përcaktimi i fushave të magazinimit të mbeturinave të ngurta.

Shumica e të intervistuarve (mbi 85%) mendojnë se për zhvillimin e turizmit në Park kërkohen rrugë më të mira; infrastrukturë dhe mjedis më të pastër (trajtimi i mbeturinave të ngurta dhe i ujrave të zeza); përgatitja dhe menaxhimi i plazheve (pastrimi) dhe furnizimi me ujë të pijshëm dhe energji elektrike.

Infrastruktura e furnizimit me ujë të pijshëm është pothuajse e paralizuar që nga viti 1997. Përpara 1997 ka ekzistuar një sistem i rregullt i furnizimit të popullsisë me ujë nga liqeni. Mbi 80% e të intervistuarve mendonin se nevoja për të siguruar furnizim të rregullt me ujë të pijshëm mund të realizohet me anën e rikonstruksionit të rrjetit të mëparshëm.

Të dhënat e marra treguan se të intervistuarit kishin njohuri të mira mbi

furnizimin me energji, sepse rreth 93% prej tyre e përcaktonin zhvillimin e turizmit në të ardhmen, si një problem të ndërvarur nga natyra dhe burimet e sigurimit të energjisë. Ndërkaq, vlerësimet e kryera nga ne tregojnë se në nivel rajoni rreth 50% të kërkesës për energji për përdorim shtëpijak plotësohet nga drutë e zjarrit. Niveli i përdorimit të burimeve të tjera alternative të energjisë është shumë i ulët. Megjithatë, kohët e fundit është rritur roli i gazit për gatim. Të intervistuarit (mbi 75%) mendojnë që në të ardhmen t'i jepet prioritet përdorimit të energjisë diellore, veçanërisht për ngrohje të ujit dhe gatim.

Në Grazhdani (2007) jepet procedura e njehsimit të së ardhurës së gjeneruar nga turizmi. Bazuar në këtë procedurë, ardhura e gjeneruar gjatë një viti nga turizmi është rreth 3 360 000 lekë (28 000 €).

PËRFUNDIME

Niveli i ulët i mekanizimit të bujqësisë në zonë si edhe mungesat në infrastrukturën e saj bazë (p.sh. ujitja, transporti etj) dhe në shërbimet (p.sh. tregu i tokës, sistemi i kreditit, shërbimi i ekstensionit etj.) përbëjnë faktorët kryesorë pengues për zhvillimin rural të zonës që ndikojnë negativisht edhe mbi turizmin. Gati 100 % e produkteve blegtorale përdoren për konsum shtëpiak (vetjak). Sasira të vogla qumështi dhe djathi shiten tek fqinjët dhe rreth 20 % e mishit shitet në fermë tek tregëtarët dhe brenda komunitetit (qingja dhe keca brenda komuniteti dhe viça tek tregëtarët); rreth 65 % e sasisë së qumështit përdoret për prodhim djathi dhe pjesa që mbetet përdoret nga njerëzit për pirje ose për prodhim kosi dhe gjalpi. Brenda Parkut Kombëtar nuk ka tregje dhe as dyqane për të blerë produkte të freskëta dhe për rrjedhojë, çdo familje në zonë mbulon nevojat për produkte bulmeti dhe mishi me anën e prodhimit vetjak të tyre; nuk ka kapacitete marketingu dhe përpunimi. Ekzistenca e një organizimi më të mirë (p.sh. kooperativat, shoqatat etj.) ndërmjet fermerëve në rajonin e Parkut Prespa mund të luajë një rol të rëndësishëm në zhvillimin e qëndrueshëm të zonës. Në Prespë asnjë nga fermerët nuk është anëtar i ndonjë forme kooperimi, sepse mungojnë aktivitetet e tilla në zonë.

Përfundimi që nxirret mbi gjendjen e indikatorëve demografikë është se ekosistemi i Parkut Kombëtar Prespa ka një gjeneratë të re

popullsie, por me mundësi të kufizuar për të gjetur punë. Sfidat kryesore me të cilat duhet të përballet komuniteti i këtij ekosistemi janë: krijimi i mundësive për punësim në të ardhmen në sektorin e turizmit dhe të shërbimeve si edhe një mbështetje të barazisë gjinore për shkollim dhe punësim.

Gjetja e një balance të përshtatshme ndërmjet ruajtjes dhe konservimit të burimeve natyrore dhe historike të zonës si edhe promovimit të zhvillimit ekonomik dhe të turizmit, vazhdon të jetë një problem dominant në Parkun Kombëtar Prespa.

Problemet që shqetësojnë infrastrukturën teknike në ndihmë të turizmit janë disa. Së pari, nevoja për të siguruar furnizim të rregullt me ujë të pijshëm. Një gjë e tillë mund të realizohet me anën e rikonstruksionit të rrjetit të mëparshëm. Së dyti, instalimi i një rrjeti telekomunikacioni të rregullt dhe cilësor publik ose familjar dhe së fundi, në kushtet e zhvillimit të turizmit, furnizimi me energji elektrike duhet të jetë me tension konstant, i vazhdueshëm dhe me një rrjet të riparuar.

Trajtimi i ujrave të zeza përmirëson direkt cilësinë e ujit të liqeneve. Për këtë qëllim, është i nevojshëm ndërtimi i një sistemi tubacioni ku të derdhen (mblidhen) ujrata e zeza në fshatrat afër liqeneve që kanë një impakt të madh mbi to (p.sh., në zonën e Liqenasit dhe asaj të Goricës së Vogël) si edhe në ndërtimin i fasiliteve të nevojshme për trajtimin e ujrave të zeza, p.sh. trajtimi biologjik.

REFERENCAT

GIANNIS CHARDALOUPAS. (2006). Introduction of a Prespa Park Trademark. Society for the Protection of Prespa.

GRAZHDANI D. (2006). Vlerësimi social-ekonomik i disa praktikave bujqësore konservuese në parkun Kombëtar të Prespës. Revista Shqipëtare e Shkencave Bujqësore, Nr. 8, 34 - 42.

GRAZHDANI D. (2007). Analiza socio-ekonomike të grupeve kryesore të interesit në Parkun Kombëtar Prespa. Mikrotezë, 93 faqe.

KfW. (2005). KfW Feasibility Study: Project Preparation & Development of the Transboundary Prespa Park Project.

Strategic Action Plan for the Sustainable Development of the Prespa Park. 2005. Aghios Germanos.

UNDP/GEF. (2004 a). Assessment of Globally Significant Biological Biodiversity

within Micro and Macro Prespa Lake Watershed. PDF- B Biodiversity Report.

UNDP/GEF. (2004 b). Integrated Ecosystem Management in the Prespa Lakes Basin of Albania, FYR-Macedonia and Greece. PDF-B Project Document.